

# CILA ËSHTË PROCEDURA E APLIKIMIT ONLINE PËR MJEKUN FAMILJAR?

Për të përzgjedhur mjekun familjar duhet të keni një **profil aktiv** në **eKosova**

Kyçuni në uebfaqen **eKosova**



**Dhe kliko në opsionin:**

Shërbime < Shëndeti < Kërkesë për përzgjedhen e mjekut familjar



Kërkesë për përzgjedhen e mjekut familjar

Nga aty do të kaloni në një dritare të re ku duhet të plotësoni të **dhënat tuaj personale** bazuar në **gjendjen civile**, dhe të përzgjedhni **mjekun familjar**.

Mjekun e njëjtë mund ta zgjedhni edhe për **anëtarët e familjes**, **duke klikuar në opsionin:**

Shërbimi < Shëndeti

< Kërkesë për përzgjedhjen e mjekut familjar për persona të tjerë.



Kërkesë për përzgjedhjen e mjekut familjar për persona të tjerë.

Nga aty do të kaloni në një dritare të re ku duhet të plotësoni të dhënat e **anëtarëve të familjes** tuaj, si dhe mjekun që dëshironi të **përzgjedhni** për ta.


## Njoftim

XXXXXX,

Aplikimi juaj në emër të XXXXXXXX për përzgjedhjen e mjekut familjar Agjkm Krasniqi në QMF-Hajvali është dërguar për shqyrtim

Mbyll

Kërkesa juaj do të shqyrtohet, dhe **mjeku juaj** do të përcaktohet shumë **shpejt**.



Nëse e keni të pamundur të aplikoni online për mjek familjar, vizitoni QMF më të afërt të zonës tuaj të banimit apo telefononi **080030900** për asistencë!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health



#Mjeku im – shëndeti im

# PËRZGJEDHJA E MJEKUT FAMILJAR



# KUSH ËSHTË MJEKU FAMILJAR?

Mjeku familjar ofron shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe efikase për individët dhe familjet në të gjitha fazat e jetës. Si mjek i përzgjedhur, shërben edhe si pikë referuese për specialistët këshillues në nivelet e kujdesit shëndetësor.

## PSE DUHET TË PËRZGJEDHNI MJEKUN FAMILJAR?

- Është obligim dhe e drejtë e çdo qytetari;
- Keni një adresë të caktuar për tu lajmëruar çdo herë për shqetësimet tuaja;
- Qasje më e lehtë dhe e shpejtë në shërbime shëndetësore;
- Kosto-efektiviteti socio-ekonomik;
- Koordinimi i shërbimeve mes niveleve tjera të kujdesit shëndetësor.



## ÇKA PËRFITONI ME PËRZGJEDHJEN E MJEKUT FAMILJAR?

- Krijim të besueshmërisë mes mjekut, pacientit dhe familjes;
- Bashkëpjesëmarrje aktive në menaxhimin dhe trajtimin e sëmundjeve;
- Përfitim të njohurive për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit tuaj, përmes edukimit dhe promovimit shëndetësor;
- Parandalim të sëmundjeve;
- Fuqizim të njohurive për vetëmenaxhim të sëmundjeve kronike;
- Përcjellje të vazhdueshme të shëndetit; Historia shëndetësore e pacientit
- Përfitim të shërbimeve cilësore dhe të kënaqshme.

## A MUND TA PËRZGJEDH EDHE FAMILJA IME MJEKUN TIM FAMILJAR?

Ju dhe familja juaj mund të përzgjedhni mjekun e njëjtë familjar!

## A MUND TA NDËRROJ MJEKUN FAMILJAR?

Po, ju mund ta ndërroni mjekun familjar, por sipas kritereve të caktuara!

## KUR MUND TA NDËRROJ MJEKUN FAMILJAR?

Ju mund ta ndërroni mjekun familjar bazuar në kriteret e caktuara!